



DEKLARATA E TË DREJTAVE

I dorëzohet një personi të ndaluar në ekzekutim të një urdhër arresti evropian, të një kërkesë për arrestim të përkohshëm ose të një ekstradimi

Ju jeni arrestuar në bazë të një urdhër arresti evropian, të një kërkesë për arrestim të përkohshëm ose të një ekstradimi. Ky dokument përfshin të drejtat kryesore që ju gëzoni.

Informacionet e mëposhtme duhet të jipen në një gjuhë që ju e kuptoni.

Ju mund të mbani këtë dokument gjatë gjithë kohëzgjatjes së ndalimit

Ju jeni informuar se jeni ndaluar sepse jeni i kërkuar me kërkesë të një Shteti të huaj në ekzekutim të një urdhër arresti evropian ose në vijim të një kërkesë për ekstradim ose për arrestim të përkohshëm për qëllime ekstradimi ose ekzekutimi të një dënimi.

Njohja e shkeljes

Ju keni të drejtë të njihni cilësimin, datën dhe vendin e kryerjes së veprës penale për të cilat urdhër arresti evropian, kërkesa për arrestim paraprak ose për ekstradim është lëshuar kundër jush.

Asistenca nga një avokat

Zgjedhja e avokatit

Që nga fillim i ndalimit, ju mund të ndihmë nga ana e një avokati të zgjedhur prej jush ose të caktuar kryesisht. Nëse ju nuk jeni në gjendje të caktoni një avokat ose nëse avokati i zgjedhur nuk mund të kontaktohet, ju mund të kërkonit që një avokat t'ju caktohet kryesisht.

Avokati juaj mund të caktohet gjithashtu nga një prej personave që keni njoftuar : Në këtë rast, ju duhet të konfirmoni caktimin e avokatit.

Asistenca dhe periudha e ndërhyrjes së avokatit

Avokati mund të takohet me ju për 30 minuta në kushte që garantojnë konfidencialitetin e takimit;

Marrja juaj e parë në pyetje, përveç nëse përfshin vetëm elemente identiteti, nuk mund të fillojë pa praninë e avokatit tuaj përpara mbarimit të afatit prej dy orësh pas njoftimit që i është bërë atij lidhur me kërkesën tuaj.

Nëse avokati juaj paraqitet gjatë marrjes në pyetje, ky veprim mund të ndërpritet me kërkesën tuaj, për t'ju lejuar që të takoheni me të.

E drejta për të ruajtur heshtjen

Gjatë ndalimit tuaj, ju mund të zgjidhni të lëshoni deklaratë, t'i përgjigjeni pyetjeve që do t'ju bëhen ose të heshtni.

Asistenca e përkthyesit

Nëse ju nuk e flisni apo nuk e kuptoni frëngjishten, keni të drejtën të përfitonit asistencë falas nga një përkthyes gjatë marrjes suaj në pyetje dhe për të komunikuar me avokatin tuaj.

Kohëzgjatja e heqjes së lirisë dhe vazhdimi i procedurës

Ndalimi juaj mund të zgjasë dyzetë e tetë orë, pa zgjatje të përkohshme.

Në fund të kësaj periudhe, ju do të dërgoheni përpara prokurorit të përgjithshëm me kompetencë territoriale ose që është marrë me çështjen tuaj, i cili pas verifikimit të identitetit tuaj, do t'ju informojë në një gjuhë që ju kuptoni, mbi ekzistencën dhe përmbajtjen e urdhër arrestit evropian ose për kërkesën e arrestimit të përkohshëm apo për ekstradimin, subjekt i të cilit ju jeni, për mundësinë e asistimit tuaj nga ana e një avokati të zgjedhur nga ju, ose në mungesë të kësaj, prej një avokati të caktuar kryesisht nga kryetari i dhomës së avokatëve i cili do të informohet që prej atij çasti në çfarëdo mënyre.

Në këtë rast ju do mund të takoheni menjëherë me avokatin e caktuar, i cili mund të shqyrtojë pa humbur kohë dosjen dhe të komunikojë lirisht me ju.

Në vijim të këtij njoftimi të urdhër arrestit evropian, të kërkesës për arrestim të përkohshëm ose të ekstradimit, në rast se prokurori i përgjithshëm vendos të mos ju lirojë, ju do të paraqiteni përpara kryetarit të gjykatës së apelit, ose gjyqtarit të caktuar prej tij, i cili do të mund:

- ose të urdhërojë dërgimin tuaj në burg deri në marrjen e pjesëve formale të ekstradimit (periudhë e ndryshme sipas konventave) dhe paraqitjen tuaj në dhomen e hetimit e cila do të vendosë rreth kërkesat e dorëzimit në ekzekutim të urdhër arrestit evropian ose të ekstradimit;
- ose, në qoftë se ai vlerëson se paraqitja juaj posedon garanci të mjaftueshme në të gjitha aktet e procedurës t'ju vendosë nën kontroll gjyqësor, ose t'ju caktojë në një vendbanim nën mbikëqyrje elektronike, ose t'ju lërë të lirë pa kontroll gjyqësor, deri në marrjen e pjesëve formale të ekstradimit ose t'ju dërgojë përpara dhomës së hetimit e cila do të vendosë nëse e pranon dorëzimin tuaj pranë Shtetit kërkuar.

Mundësia për të pranuar dorëzimin tuaj

Ju keni të drejtën të pranoni ose jo dorëzimin tuaj pranë Shtetit që ju kërkon. Dhoma e hetimit duhet të vendosë në periudhën më të shkurtër kohore në rast pranimi. Nëse ju pranoni dorëzimin tuaj në kuadrin e një urdhër arresti evropian, vendimi juaj nuk do të mund të ndryshohet më vonë.

Informacion i disa personave

Ju keni të drejtë të njoftoni personat që dëshironi, dhe sidomos anëtarët e familjes suaj, për ndalimin subjekt i të cilit ju jeni.

Ju gjithashtu mund të informoni autoritetet konsullore të vendit tuaj nëse keni kombësi të huaj.

Vizita nga një mjek

Ju mund të kërkonti të vizitoheni nga një mjek gjatë ndalimit.